



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 141, datë 27.10.2011**

**MBI MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE NË SHOQËRINË E  
SIGURIMIT “INTERSIG” SH.A**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 6/h, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 56, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**KONSTATOI SE:**

Shoqëria e sigurimit “Intersig” sh.a, me shkresën nr. 1438, datë 02.09.2011, ka depozituar kontratën e shitblerjes midis aksionarit Gani Hoxha dhe aksionarit Gentian Sula për shitjen e 8.449 aksioneve në shoqërinë “Intersig” dhe që përfaqësojnë 21,12% të kapitalit aksionar. Gjithashtu me shkresën nr. 1688, datë 14.10.2001 shoqëria ka depozituar kontratën midis aksionarit Natasha Koço dhe aksionarit Besiana Antoni për shitjen e 7.981 aksioneve në shoqërinë “Intersig” sh.a, që përfaqësojnë 19,95% të kapitalit aksionar. Aksionarët e shoqërisë kanë mbyllur transaksionin financiar sipas kësteve të kontratave, siç përcaktohet në dokumentet bankare.

Në Autoritet është depozituar deklarata noteriale, nëpërmjet të cilës aksionaret e mëparshëm deklarojnë marrjen e pagesës dhe mospasjen e asnjë pretendimi ndaj shoqërisë si dhe deklarata e mbylljes së transaksionit të parë midis Viena Insurance Group dhe aksionareve G. Sula, B. Antoni dhe F. Meta, më datë 10.10.2011, e cila nënkupton edhe plotësimin e kushtit të vendosur në Marrëveshjen për shlyerjen e aksionareve të mëparshëm z. G. Hoxha dhe zj. N. Koco.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të aksionarit Gentian Sula nga 51% në 72,12% në kapitalin e shoqërisë së sigurimit “Intersig” sh.a.
2. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të aksionarit Besiana Antoni nga 6,56% në 26,51% në kapitalin e shoqërisë së sigurimit “Intersig” sh.a.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Elisabeta GJONI**